



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 21, datë 31.01.2023

PËR
MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E FAMILJEVE,
QË KËRKOJNË TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL

Në mbështetje të Ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr.22/2018 “Për strehimin sociale”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.814, datë 03.12.2004 “Për normat e strehimit për familjet, që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 453, datë 3.7.2019 “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet, që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.459, datë 3.7.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore” dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e familjeve, që kërkojnë të përfitojnë nga programet e strehimit social sipas tabelës së mëposhtëme:

Nr.	KRITERET	SHKALLA E VLERËSIMIT
1	Jetoni në shtëpi private me qira ose ndani shtëpinë me një numër të madh pjesëtarësh të familjes me një sipërfaqe të banuar nën normat e strehimit.	0/20
2	Jetoni në shtëpi private me qira ose ndani shtëpi me një numër të madh pjesëtarësh të familjes ku banesa ka kushte jo të mira sanitare ose rrezikon shembjen	0/10
3	Familjet me nevoja të veçanta në një nga kategoritë e mëposhtme*:	0/20
	a. Personat të moshuar në moshë pensioni dhe që nuk mund të përzgjidhen për të përfituar strehim nga institucionet sociale të kujdesit publik.	0/2
	b. Individët me aftësi të kufizuara, që kanë statusin e personit të verbër dhe që i përkasin grupit të parë, invalidët si për shembull paraplegjikët, invalidët e punës ose të luftës së dytë botërore.	0/10
	c. Individët me statusin e jetimit, nga momenti që ata braktisin jetimoren ose qendrat e përkujdesjes deri në moshën 30 vjeçare	0/8
4	Familjet në vështirësi ekonomike në një nga kategoritë e mëposhtme:	0/10
	a. Familjet me një prind të vetëm me fëmijën në ngarkim ku kryefamiljare është i/e ve ose i/e divorcuar ose familje me më shumë së 4 fëmijë	0/4
	b. Familjet e policëve të rënë në detyrë.	0/3
	c. Viktimat e dhunës në familje	0/3
5	Familjet e përshtatshme për ndihmë për strehim në një prej kategorive të mëposhtme:	0/10
	a. Familjet e reja me një moshë totale deri në 60 vjeç.	0/3
	b. Familjet që kanë ndryshuar vendbanimin e tyre për arsye punës	0/2
	c. Familje të komunitetit rom dhe egjiptian ose Familje që përfshihen nga ligji nr.82/2012 "Për miratimin e aktit Normativ nr.3 datë 01.08.2012 "Për lirimimin e banesave të pronarëve të ligjshëm nga qytetarë të pastrehë banues në banesat ish-pronë e subjekteve tëshpronësuar."	0/5
6	Kategoritë e të ardhurave	0/30
	a.Kufiri maksimal i të ardhurave deri 75% e të ardhurave mesatare kombëtare Ap (1+1) për familjet me 2 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (47,672 -70,243) Lekë Ap (1+1) për familjet me 3 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (82,501– 92,550) Lekë Ap (2+1) për familjet me 4 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (100,501– 105,589) Lekë Ap (2+1) për familjet me 5 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (101,501–104,659) Lekë	0/5
	b.(niveli mesatar i të ardhurave) Ap (1+1) për familjet me 2 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga 34,001 – 47,671 Lekë Ap (1+1) për familjet me 3 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (75,501–82,500) Lekë Ap (2+1) për familjet me 4 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (95,501–100,500) Lekë Ap (2+1) për familjet me 5 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (96,501–101,500) Lekë	0/10

<p>c.(niveli minimal i të ardhurave)</p> <p>Ap (1+1) për familjet me 2 pjestarë dhe me të ardhura mujore deri në 34,000 Lekë Ap (1+1) për familjet me 3 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (70,244–75.500) Lekë Ap (2+1) për familjet me 4 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (92,551–95.500) Lekë Ap (2+1) për familjet me 5 pjestare dhe më të ardhura mujore nga (93,551–96.500) Lekë</p>	<p>0/15</p>
---	-------------

2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 02.02.2023





09/02/23 2736

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 85/prot.
9

Durrës, më 09.02.2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.21 datë 31.01.2023 “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e familjeve që kërkojnë të përfitojnë nga programet e strehimit social.”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

